



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KP.nr. 34/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit N.P.N “H...” me NRB ....., me seli në Prizren rrugën “....”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Fortesa Mehmeti Syla me seli Prishtinë, ndaj të paditurve Kompania e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina Sh.a., me seli në Prishtinë dhe Komuna e Prishtinës të cilën e përfaqëson sipas autorizimit shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini” Sh.p.k., me adresë Lagja Veternik, kompleksi EXDC 3, Blloku 10 kati 6, numër 18, me objekt kontesti, pengim posedimi, jashtë seance me datën 09.11.2022 merr këtë :

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e pa lejuar padia e paditësit N.P.N “H...” me NRB ....., me seli në Prizren, ndaj të paditurve Kompania e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina Sh.a me seli në Prishtinë dhe Komuna e Prishtinës, me objekt kontesti ndërprerjen e cenimit të mëtejme të paditësit në shfrytëzimin e lirë dhe të pa penguar të pronës.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi N.P.N “H...” me seli në Prizren, përmes të autorizuarit Av. Naser Peci më datën 23.11.2015 në Gjykatën Themelore Prishtinë ka ushtruar padi, ndaj të paditurve Kompania e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina Sh.a me seli në Prishtinë dhe Komuna e Prishtinës me objekt kontesti, largimin e cenimit të pronarit (pengim posedimi), duke i propozuar gjykatës që të obligohen të paditurit ta ndërpresin cenimin e mëtejme të paditësit në shfrytëzimin e lirë dhe të pa penguar të palujtshmërisë, ashtu që të zhvendosin gypin magjstral Fi 600 mm nga palujtshmëria si dhe në mënyrë solidare ta kompensojnë dëmin e shkaktuar.

I padituri i parë KRU Prishtina, me parashtresën e datës 27.06.2017, përgjigje në padi, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa rregullt, në veçanti kërkesëpadia duhet të precizohet në të kundërtën gjykata duhet ta hedhë poshtë si të pa lejuar, të sqarojë bazën juridike të kërkesëpadiës për më tej do të deklarohet në seancën përgatitore, e duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi padinë e paditësit ndaj të paditurës së parë KRU Prishtina.

I padituri i dytë Komuna e Prishtinës me parashtresën e datës 16.06.2027 përgjigje në padi, e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit, duke pretenduar se i mungon legjitimiteti aktivë palës paditëse në rastin konkretë gjithashtu ka pretenduar se i mungon edhe legjitimiteti pasivë të paditurisë Komuna e Prishtinës, pasi që e njëjta nuk menaxhon me gypat e ujësjellësit, e paditura Komuna e Prishtinës i ka përmbushur obligimet e sajë sa i përket pajisjes së paditësit me leje urbanistike dhe leje ndërtimore në procedurë të ligjshme administrative, ndërsa sa i përket pengesave të natyrës teknike lidhur me gypin e ujësjellësit të njëjtin nuk e ka instaluar, as nuk është përgjegjëse për mirëmbajtjen e tij, ashtu që nuk ka as një lloj përgjegjësie për heqjen apo mënjanimin e këtij gypi nga pozicioni në të cilin e ka vendosur kompania e ujësjellësit, andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit ka caktuar dhe mbajtur seancë përgatitore më datën 20.10.2022 në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve në procedurë.

E autorizuar e paditësit pos tjerash ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padinë e ushtruar më datën 23.09.2015, si dhe në këtë seancë ka dorëzuar parashtresën për precizimin e padisë dhe kërkesë padisë, përmes së cilës ka kërkuar që të aprovohet kërkesë padia e paditësit në tërësi si e bazuar dhe atë të detyrohen të paditurit në mënyrë solidare në emër të dëmit dhe fitimin e humbur të shkaktuar me vonesën e ndërtimit të objektit A-3 me etazhitet 2B+P+8+NK blloku A11e njësisë katastrale P-..... ZK Matiqan si pasoj e mos zhvendosjes me kohë të gypit magjstral të ujësjellësit Fi 600mm nga njësia kadastrale P-..... ZK Matiqan, ti paguaj dëmin me kamatë ligjore sipas ekspertizës financiare dhe atë në afate prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit e deri në ditën e pagesës nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

E autorizuar e paditëses së parë pos tjerash ka deklaruar mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë si dhe precizimin e padisë si të pa bazuar dhe të pa

argumentuar në prova, duke theksuar se në këtë çështje juridike paditësi duhet të sqaroj bazën e precizimit të dorëzuar në këtë seancë, nuk dihet se çfarë objekt kontesti përmban tani kjo çështje. I autorizuari i të paditurit të dytë pos tjerash ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, lidhur me precizimin e padisë i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta kthej në plotësim, pasi që sipas të njëjtës nuk mund të veprohet.

Gjykata me Aktvendim të datës 20.10.2022, në procesverbal e ka obliguar paditësit që në afat prej 3 ditësh ta bëjë precizimin – plotësimin e padisë, meqenëse sipas padisë dhe precizimit të padisë gjykata sipas të njëjtave nuk mund të veprohet.

E autorizuar e paditësit me datën 24.10.2022 me parashtrësë për plotësimin dhe përmirësimin e padisë, ka bërë ndryshimin e padisë ashtu që në dispozitiv ka kërkuar që të detyrohen të paditurit në mënyrë solidare në emër të dëmit të shkaktuar me vonesën e ndërtimit të objektit A-3 si pasojë e mos zhvendosjes së gypit magjistral ti paguajnë dëmet e shkaktuara dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në afate prej 15 ditësh nga pranimi i Aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata pas pranimit të parashtrësës për precizimin e padisë të njëjtën e ka vlerësuar konform dispozitës së nenit 480 të LPK-së i cili përcakton *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përrjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.”*

Meqenëse në rastin konkret padia është inicuar si padi për shkak të pengim posedimit dhe me parashtrësën e datës 24.10.2022, është bërë precizimi i padisë ashtu që është tërhequr kërkesa sa i përket pengimit të posedimit por ka mbetur vetëm shpërblimi i dëmit, dhe gjykata në mbështetje të nenit 480 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Ngase sipas dispozitës së lartë cekur rrjedh se procedura e pengim posedimit është një procedurë e veçantë, në këtë kuptim ligjdhënësi në mënyrë të qartë, procedurën e pengim posedimit e ka

konsideruar si procedurë të veçantë kontestimore, me qëllim që procedura e pengim posedimit mos ta konsumojë asnjë procedurë tjetër që lidhet me të drejtat tjera.

Specifike e kësaj procedure është edhe fakti se procesi gjyqësor i filluar sipas padisë së pengim posedimit nuk mund të ndryshohet në një procedurë tjetër. Pra, nëse një proces gjyqësor është filluar me padi për pengim posedim, domosdoshmërisht edhe përfundimi do të jetë për pengim të posedimit, prandaj padisë për pengim posedim nuk mund t'i ndërrohet baza juridike, pasi që kjo procedurë dallon nga procedurat tjera ku pala paditëse potencialisht mundet gjatë gjykimit ta ndryshojë objektin e kontestit.

Në procedurën e pengimit të posedimit përjashtohet mundësia që të jetë objekt kontesti edhe kërkesa tjetër përkitazi me shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit, sepse kërkesa për kompensim dëmi mund të jetë objekt i një shqyrtimi tjetër në të cilin ndiqen rregullat standarde për të përcaktuar përgjegjësinë e të paditurit përkitazi me detyrimin e kompensimit të dëmit dhe konstatimin e lartësisë së dëmit.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 480 të LPK-së , gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452, të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.34/22, datë 09.11.2022

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.